

Të nderuar Klient, lexoni dhe familjarizohuni me kushtet e kontratës dhe të drejtat tuaja para se të pranoni kushtet e kontratës duke firmosur mandatin e rezervim/arkëtimit.

Kontrata e paketave te udhetimit

e lidhur ndërmjet

KABA TRAVEL & TOURS me seli qendrore Rr.Kavajes, Kulla nr 1,Kati 1 Perball qendres Globe, 1001, Tiranë, Shqipëri, me NIPT nr.L71528019b (këtu dhe më poshtë referuar si "**Kevin Kaba Person fizik**") - *nga njëra anë*

Dhe

Z./Zj _____, qytetar shqiptar, me adresë elektronike nr. _____, telefon numër _____ (më poshtë bashkërisht quajtur, "**Klienti**" ose "**Pasagjeri**" ose "**Udhëtari**") -*nga ana tjetër,*

(në vijim së bashku referuar edhe si "**Palët**", dhe veçmas si "**Pala**").

Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake si vijon:

a) **KABA TRAVEL & TOURS** dëshiron të ofrojë paketa udhëtimi të dizenuara dhe organizuara nga ajo apo palë të treta të lidhura me të;

b) Klienti ka kërkuar dhe dëshiron të përftojë paletat e udhëtimit në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate;

Palët, bazuar në Ligjin nr.93/2015 "*Për Turizmin*", i ndryshuar Ligjin nr.9902 në datë 17.04.2008, "*Për mbrojtjen e Konsumatorit*"; Ligjntnr.7850,datë29.07.1994"*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*", indryshuar; Ligjinnr.9887, date 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar, bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 - Përkufizime

1.1 "**Kontratë**" është kjo marrëveshje e lidhur ndërmjet Klientit me Kaba Travel Tours në të cilën Klienti detyrohet të paguajë një çmim të caktuar gjithëpërfshirës për kundrejt përftimit të paketës së udhëtimit të ofruar nga Kaba Travel Tours.

1.2 "**Paketë Udhëtimi**" është shërbimi që i siguron Klientit një kombinim të parapërgatitur të një ose më shumë nga llojet e mëposhtme të shërbimeve: transporti, akomodimi, shërbime të tjera turistike, që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me transportin ose akomodimin dhe që përbëjnë pjesë të konsiderueshme të paketës si dhe mbulon një periudhë kohore prej jo më pak se 24 orë ose që përfshin akomodimin, të paktën për një natë.

1.3 "**Rezervimi**", porositja nga ana e Klientit të një pakete turistike apo të një akomodimi të ofruar nga Kaba Travel Tours.

1.4 "**Penalitetet**" vijnë si pasojë e mospërbushjes nga ana e klientit të njëres nga kushtet bazë të rezervimit që janë: a) mosparaqitja fizike në oraret dhe/ose datat e paracaktuara në rezervim b) transferimi i shërbimit nga personi i parashikuar në rezervim në një person të tretë jashtë afateve të përcaktuara në termat dhe kushtet e rezervimit.

Neni 2 - Objekti i Kontratës

2.1 Kjo Kontratë ka për objekt rregullimin e marrëdhënies kontraktore ndërmjet Kaba Travel Tours dhe klientit me qëllim ofrimin e shërbimit të Paketës së Udhëtimit dhe shërbimet te tjera udhëtimesh (hotele, bileta avioni, bileta trageti, bileta autobusi, siguracione, makina me qira, transfertat, etj) sipas së cilës klienti detyrohet të paguajë një

çmim të caktuar gjithëpërfshirës përkundrejt paketës turistike të ofruar nga Kaba Travel Tours sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

2.2 Paketa e Udhëtimit të hartuar nga Kaba Travel Tours duhet të ketë përcaktuar në të: (destinacionin e udhëtimit _____ datat e nisjes dhe te kthimit _____ mjetin e transportit te perdorur _____ itinerarin e udhëtimit; _____ tipin e strukturës së akomodimit, vendndodhjen _____ klasifikimin dhe karakteristikat kryesore të saj; _____ planin e vakteve të ngrënies, nëse përfshihen; _____ listën e shërbimeve të tjera që ofrohen për klientët brenda çmimit të paguar; _____ listën e shërbimeve që nuk përfshihen në çmimin e paguar _____ listën e shërbimeve shtesë, që mund të blihen veçmas _____ numrin minimal të personave të domosdoshëm për realizimin e paketës së udhëtimit si dhe mundësinë që Kaba Travel Tours të rezervojë të drejtën për të ndryshuar kushtet e kësaj Pakete.

Neni 3– Çmimi

3.1 Çmimi i përfundimtar i Paketës së Udhëtimit është _____ [shuma në numra, *shuma në fjalë, monedha (Lekë ose Euro)*] (më poshtë referuar edhe si “Çmimi përfundimtar” ose “Çmimi”).

3.2. Në Çmimin përfundimtar janë përfshirë: i) çmimi i biletës së udhëtimit, ii) çmimi i akomodimit (me mëngjes, ose vaktet e përfshira) iii) çmimi i transfertes aeroport-hotel-aeroport.

3.3. Në Çmimin përfundimtar nuk janë përfshirë tarifat shtesë si shërbime me kosto, taksa lokale, apo taksa te ndryshme shërbimi qe varjojnë sipas llojit të shërbimit dhe vëndodhjes, për vizita në monumente, muzeume, vende argëtimi, ekskursione të ndryshme, sigurimi i shëndetit në udhëtim.

3.4 Çmimi i përcaktuar sipas kësaj Kontrate është i pandryshueshëm, përveç rasteve kur ndryshojnë kostot e transportit apo te karburantit, ii) ndryshojnë tarifat në porte dhe aeroporte, iii) ndryshon kursi i këmbimit monetar deri në datën e nisjes, iv) në rastet kur vlera e njoftuar apo paguar e Paketës së Udhëtimit është më e ulët se vlera reale e shërbimit turistik përkatës, për shkak të gabimeve që vijnë si pasojë e mosfunksionimit të sistemeve të rezervimit online, duke patur detyrimin të paguajë diferencën me Çmimin real të Paketës së Udhëtimit.

3.5 Në rast të ndryshimi të Çmimit, Klienti do të njoftohet përkatësisht sipas afateve të përcaktuara më poshtë, së bashku me njoftimin edhe të të drejtave të tij përkatëse sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Neni 4- Kushtet, Kalendari dhe Mënyra e Pagesës

4.1 Me nënshkrimin e Kontratës, Klienti merr përsipër të derdhë një paradhënie të barabartë me sa parashikohet në katalogun e referimit të çmimeve të Paketave të Udhëtimit, ose komunikimit te ofertës me shkrim në një nga kanalet e komunikimit elektronik, ose verbalisht në zyrat e Kaba Travel Tours, e gjithësesi, jo më pak se 30% të Çmimit total të Paketës së Udhëtimit, ndërsa 70% (ose pjesa e mbetur nëse ndryshe) e pagesës duhet të kryhet të paktën 31 (tridhjet e një) ditë përpara nisjes me përjashtim të rasteve të specifikuara në ofertën e dhënë nga Kaba Travel Tours me shkrim ose verbalisht nga agjentët e shitjes.

4.2 Për Kontratën e nënshkruar deri 31 (tridhjet e një) ditë përpara nisjes sipas Paketës së Udhëtimit, Çmimi përfundimtar total duhet të derdhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në një derdhje të vetme me përjashtim të rasteve të që specifikohen ndryshe gjatë ofertës.

4.3 Të gjitha afatet e pagesës sa më sipër janë të detyrueshme e thelbësore dhe Klienti pranon shprehimisht se moskryerja e pagesës brenda afateve sipas nenit 4.1 e 4.2 më sipër, përbën shkelje të kushteve thelbësore të kësaj Kontrate me pasojë zgjidhjen e menjëhershme të saj kundrejt penaliteteve sipas nenit 7.2 më poshtë.

4.4 Pagesa për Paketën e Udhëtimit kryhet i) me para në dorë (cash), ii) transfertë bankare, iii) kartë krediti ose debiti kundrejt nje kosto 2% shtesë mbi vlerën e shërbimit, iv) transferim ndërkombëtar parash.

Neni 5 – Fluturimi

5.1 Oraret e fluturimit të publikuara në katalogun e Paketës së Udhëtimit mund të pësojnë ndryshime deri në 24 orë ditën e nisjes për shkaqe madhore, jashtë kontrollit të Kaba Travel Tours dhe të agjensive të treta në bashkëpunim me të.

Në këtë rast, Kaba Travel Tours do të marrë masat e duhura për zgjidhjen e problematikës në mënyrë të shpejtë dhe të korrekte për Klientin.

Klienti është i informuar dhe pranon shprehimisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate se, Kaba Travel Tours nuk do të konsiderohet se është në shkelje apo se mban përgjegjësi përkundrejt Klientit në rast vonese në ofrimin e shërbimit të transportit ajror për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore. Ngjarje e Forcës Madhore sipas këtij përcaktimi do të quhet çfarëdo ngjarje jashtë kontrollit të Kaba Travel Tours dhe Agjencisë, e cila pengon njërin nga Palët të veprojnë në përputhje me detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshje, duke përfshirë por jo kufizuar në: i) ngjarje të natyrës, por pa u kufizuar në, të tilla si, zjarret, shpërthimet, tërmetet, thatësira, valët e baticës dhe përmytjet; ii) akte lufte (nëse lufta të deklaruara ose jo) apo embargo; rebelime, revolucione, kryengritje, apo grusht shteti ushtarake apo luftë civile; apo iii) rrethana që e bëjnë të pamundur objektivisht vijimin e udhëtimit të tilla si vonesa nga destinacionet e mëparshme, vonesa të detyruara nga kontrollet kufitare, falimentimi i shoqërive të transportit ajror, greva aeroportuale.

Në çdo rast, Klienti pranon shprehimisht se, në rast të vonesave në ofrimin e shërbimit të transportit ajror nga shoqëritë e transportit ajror, çfarëdo pretendimi do të zgjidhet drejtpërdrejt me këtë operator në përputhje me kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit nga ky i fundit.

Neni 6 – Ndryshimet në Paketën e Udhëtimit dhe/ose Anullimet

6.1 Nëse deri 1 (një) ditë përpara nisjes, Kaba Travel Tours ka nevojë të ndryshojë një ose më shumë elemente të Paketës së Udhëtimit, ajo duhet të njoftojë Klientin, duke sqaruar tipologjinë e modifikimit.

6.2 Nëse Klienti nuk pranon propozimin e modifikimit sipas pikës 6.1, ai ka të drejtë të zgjidhë Kontratën duke ia njoftuar këtë vendim Kaba Travel Tours brenda dhe jo më vonë se 8 (tetë) orë nga marrja në dijeni për modifikimin, pa paguar asnjë penaltet. Në këtë rast, Klienti ka të drejtë të përdorë një tjetër paketë udhëtimi turistike me cilësi ekuivalente ose më të lartë pa asnjë shtesë në çmim ose një paketë turistike më të ulët në cilësi, me kthim të diferencës së Çmimit. Në të kundërt, Kaba Travel Tours do t'i rimbursojë Klientit shumën e paguar, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga momenti i heqjes dorë ose anulimit sipas këtij paragrafi.

6.3 Nëse Klienti nuk i komunikon Kaba Travel Tours mospranimin e tij për modifikimin e Paketës së Udhëtimit, miratimi i tij për modifikimet do të konsiderohet i mirëqenë dhe i pranuar nga ana e tij.

6.4 Kaba Travel Tours ka të drejtë të anulojë Paketën e Udhëtimit përpara nisjes e pa asnjë penaltet për shkak të i) mosplotësisht të numrit minimal të personave të regjistruar për Paketën e Udhëtimit, ii) forcës madhore.

Neni 7 – Anullimi nga Klienti

7.1 Klienti ka të drejtë të anulojë/heqë dorë nga Kontrata për çfarëdo shkak me ose e pa penaltet sipas kushteve të rezervimit të specifikuar me shkrim ose verbalisht në momentin e kryerjes së rezervimit.

7.2 Në rast se Klienti anulon/heq dorë nga Kontrata në tejkalim të afatit të përcaktuar të shërbimit në këtë nen 7.2, atëherë ai detyrohet të kompensojë Kaba Travel Tours për të përballuar kostot ndaj shërbimeve partnere turistike, vlerat e llogaritura si më poshtë vijon: Kostot e anulimit specifikohen me shkrim ose verbalisht para se të kryhet rezervimi.

7.3 Kërkesat për anulim duhet të dërgohen nga klienti në formë zyrtare, shprehimisht me shkrim, me email, me sms, ose verbalisht në ambientet fizike të Kaba Travel Tours. Kërkesat për anulim që nuk janë dërguar në formë zyrtare edhe nëse janë komunikuar me telefon, nuk janë të vlefshme.

7.4 Po ashtu, në rast të shkeljes nga ana e Klientit të çdonjërit prej kushteve bazë të Paketës së Udhëtimit si: a) mosparaqitja fizike në oraret dhe/ose datat e paracaktuara në Paketë, b) transferimi i Paketës nga personi i parashikuar në rezervim në një person të tretë jashtë afateve të përcaktuara në termat dhe kushtet e Paketës, c) ndryshimet në parametrat e Paketës (numri i netëve të qëndrimit, numri i personave që marrin shërbimin, data e nisjes dhe ndërrimi i strukturës pritëse, hotel, vilë etj) jashtë afateve të paracaktuara në Paketën e Udhëtimit, Klienti detyrohet t'i paguajë Kaba Travel Tours penalitetet në varesi të kostove ekstra të shkaktuara nga keto ndryshime.

Neni 8 - Transferimi i Paketës së Udhëtimit nga Klienti të një personi të tretë

8.1 Klienti mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Kontratës së Paketës së Udhëtimit të një palë të tretë, e cila plotëson të gjitha kushtet e Paketës së Udhëtimit. Në këtë rast:

8.1.1 Klienti njofton me shkrim Kaba Travel Tours të paktën 24 ore përpara datës së vendosur për nisjen duke e informuar atë rreth të dhënave të Klientit të ri, *dhe po ashtu*

8.1.2 Klienti i ri nëshkruan këtë Kontratë të zbatueshme për Paketën e Udhëtimit duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet sipas saj përkatësisht.

8.1.3 nëse nuk plotësohen kushtet 8.1.1 e 8.1.2 më sipër, transferimi nuk mund të kryhet.

8.2 Klienti, i cili transferon të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate të Paketës së Udhëtimit dhe personi, të i cili transferohet Paketa e Udhëtimit, janë përgjegjës, solidarë dhe veçmas, ndaj Kaba Travel Tours për pagesën e Çmimit të Paketës së Udhëtimit dhe për çdo kosto shtesë, që rrjedh nga ky transferim.

8.3 Kaba Travel Tours ka të drejtë të refuzojë transferimin sipas këtij neni për arsye që lidhen me pasaportën, vizat, çertifikatat shëndetësore, sistemit në hotel, shërbimeve të transportit ose gjithësesi arsyeve që bëjnë të pamundur përdorimin e Paketës së Udhëtimit nga ana e Klientit të ri.

8.4 E drejta e transferimit sipas paragrafeve të mësipërme nënshtrohet përjashtimeve dhe kufizimeve të parashikuara nga normat, në veçanti në fushën e sigurisë, të aplikueshme në shërbimet e veçanta që përbëjnë Paketën e Udhëtimit.

9 –Të drejtat dhe detyrimet e Kaba Travel

9.1 Kaba Travel Tours detyrohet të përmbushëtë gjitha shërbimet e përcaktuara sipas nenit 2të kësaj Kontrate.

9.2 Klienti është i informuar dhe pranon shprehimisht nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate se, në rast se hoteli apo struktura turistike e prenotuar nëpërmjet Paketës së udhëtimit bën overbooking (shet më shumë dhoma sesa ka kapacitetin) ose në rastet kur shërbimi hotelier bëhet i pamundur për shkaqe madhore si zjarr, përmytje, epidemi të ndryshme, zgjidhje të kontratave me Kaba Travel Tours, kjo e fundit do ta akomodojë Klientin në një strukturë të të njëjtës kategori ose të një kategorie më të lartë. Në këtë rast kostot shtesë do të merren përsipër të paguhen nga

Kaba Travel Tours pa asnjë detyrim shtesë për Klientin dhe ky i fundit e përjashton Kaba Travel Tours nga çfarëdolloj përgjegjësie financiare apo ligjore në këtë rast.

9.3 Agjensia e udhëtimit Kaba Travel siguron konsumatorin se perfaqësuesi I huaj do te ofroj ne cdo rast ndihmen e tij te pa kushtezuar per paketen perkatese te udhëtimit.

Klienti është i informuar dhe pranon shprehimisht se, mund të ketë diferenca midis llojit të dhomave sipas listës së çmimeve të Kaba Travel Tours dhe llojit të dhomave të paraqitura në website-t zyrtare të hoteleve ku do të ofrohet Paketa e Udhëtimit. Në këtë rast, Kaba Travel Tours do të përgjigjet vetëm dhe ekskluzivisht për informacionet dhe përshkrimet e publikuara në dokumentacionin dhe materialet zyrtare të Kaba Travel Tours.

Kaba Travel Tours nuk do të jetë përgjegjëse për çfarëdolloj dëmi të shkaktuar nga Klienti, duke përfshirë dëmet si pasojë e iniciativave autonome të ndërmarra nga ky i fundit, ose nga ato të një pale të tretë që nuk ka lidhje me ofrimin e shërbimeve të kontraktuara, të cilat janë të paparashikuara ose të pashmangshme për ngjarje të forcës madhore ose për shkak të një ngjarjeje të cilën Kaba Travel Tours dhe ose nënkontraktorët e saj, me gjithë kujdesin e duhur nuk mund ta parandalonin.

10- Të drejtat dhe detyrimet e Klientit

10.1 Klienti duhet të jetë i pajisur me pasaportë individuale, në bazë të shtetësisë së tij, duhet të ketë verifikuar vlefshmërinë e dokumentit të vizave të qëndrimit dhe të lëvizjes.

10.2 Klienti ka detyrimin për të kryer sigurimin shëndetësor për gjithë kohëzgjatjen e udhëtimit.

10.3 Klienti duhet të ofrojë informacion në momentin e rezervimit detajuar e të nevojshëm për përmbushjen e Kontratës e si më poshtë emër dhe mbiemër, adresën e postës elektronike e numrin e telefonit fiks dhe/ose mobil.

10.4 Klienti është i detyruar të paguajë Çmimin përfundimtar të Paketës së Udhëtimit sipas mënyrave dhe kushteve të përcaktuara në Kontratë.

10.5 Klienti pranon shprehimisht se ka detyrimin për të paguar penalitetet në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në nenin 7.2.e 7.4 më sipër.

11 – Ankesat

11.1 Në rastin që shërbimet e ofruara nuk përmbushin pritshmëritë e Klientit, ai është i detyruar të njoftojë menjëherë Kaba Travel Tours. Në këtë rast Kaba Travel Tours do marrë masat e duhura për zgjidhjen e problematikës në mënyrë të shpejtë dhe të kënaqëshme për Klientin.

12- Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale

12.1 Kaba Travel Tours merr përsipër të trajtojë informacionin dhe të dhënat e Klientit, si rreptësisht konfidenciale si dhe për të mbrojtur këtë informacion dhe të dhëna nga aksesit i paautorizuar.

12.2 Kaba Travel Tours nuk do të përdorë te dhenat e Klientit per qellime te tjera veç atyre te percaktuara ne Kontrate, ne vecanti nuk do te perhape te dhenat e Klientit paleve te treta per qellime qe nuk lidhen me këtë Kontratë.

12.3 Vetëm të punësuarit e Kaba Travel Tours te cilet paraprakisht kane mbeshtetur shprehimisht konfidencialitetin duke nenshkruar Deklaratat Individuale te Konfidencialitetit, në mbrojtjen e te dhenave personale te Klienteve te Kaba Travel Tours ne përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale, do të kenë akses në të dhënat dhe informacionin e mbajtur nga Kaba Travel Tours.

12.4 Kaba Travel Tours pranon se çdo e dhënë personale e përfshirë, apo e mbledhur në lidhje me këtë Kontratë do të përpunohet sipas kërkesave të nenit 2 dhe 5 të Ligjit për 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave Personale", i ndryshuar.

12.5 Për të përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale, Klienti jep pëlqimin për përdorimin e të dhënave personale nga Kaba Travel Tours që përfshin emër, mbiemër, numër telefoni dhe adresë email për t'u përpunuar ekskluzivisht sipas kriterëve specifikë të nenit 6 të Ligjit 9887. Përhapja e të dhënave personale të të tretët do të bëhet vetëm nëse këto palë janë agjentë apo janë shërbim të Kaba Travel Tours dhe veprojnë në përputhje me udhëzimet e Kaba Travel Tours dhe legjislacionin në fuqi për trajtimin e të dhënave personale.

12.6 Klienti ka të drejtën e aksesit në të dhënat e tij/saj personale dhe të korigjimit të këtyre të dhënave në zbatim të nenit 13 të Ligjit 9887.

12.7 Nëse Klienti ka pyetje në lidhje me përpunimin e të dhënave të tij/saj, ai/ajo duhet t'i adresojë ato tek Kaba Travel Tours në kuptim të nenit 12 të Ligjit 9887.

12.8 Kaba Travel Tours ka detyrimin ligjor dhe merr persiper të përgjigjet brenda një afati 30 ditor nga data e marrjes së kërkesës për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korigjimit apo të fshirjes.

12.9 Kaba Travel Tours merr persiper të zbatojë të gjitha rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të marrë autorizimin e klienteve për konfirmimin e përpunimit të të dhënave personale vetëm për qëllimin e përcaktuar në këtë Kontratë.

12.10 Kaba Travel Tours nuk përpunon të dhëna sensitive sipas nenit të Ligjit 3 të Ligjit 9887.

12.11 Kaba Travel Tours merr persiper të marrë masa të veçanta sigurie në kuptim të nenit 27 të Ligjit 9887 për të mbrojtur të dhënat personale të Klientit nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, mbron aksesin ose përhapjen nga persona të pautorizuar si dhe në ambientin ku përpunohen të dhënat qëndrojnë vetëm punonjësit që kanë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit sipas nenit 12.3 me sipër.

12.12 Klienti ka të drejtën për të kundërshtuar, në çdo kohë, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 6 të Ligjit 9887, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj. Klienti ka të drejtë pa pagesë t'i kërkojë Kaba Travel Tours të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë si dhe të informohet përpara përhapjes për herë të parë të të dhënave personale për këtë qëllim (neni 15 i Ligjit 9887).

12.13 Klienti ka të drejtën për të ankuar në rast se pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, si të ankohet ose të njoftojë komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, Klienti ka të drejtë të ankoheni në gjykatë. Në rast se klienti ka bërë ankim, Kaba Travel Tours nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar (neni 16 i Ligjit 9887).

12.14 Klienti ka të drejtën që në rast se i është shkaktuar dëm si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, të kërkojë kompensim, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Civil (neni 17 i Ligjit 9887).

Neni 13 -Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe Legjislacioni i Zbatueshëm

13.1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

13.2 Çdo mosmarrëveshje që lind gjatë afatit të kësaj Kontrate do të tentohet fillimisht të zgjidhet me bisedime midis palëve.

13.3 Nëse çështja nuk mund të zgjidhet miqësisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të ketë kompetencë ekskluzive për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në fjale.

Neni 14– Njoftimet

14.1 Çdo njoftim i kërkuar apo i autorizuar nga kjo Kontratë, të cilin njëra palë duhet t'ia japë tjetrës, duhet të kryhet me shkrim dhe do të konsiderohet i dhene kur jepet dorazi ose dërgohet me e-mail në adresat e mëposhtme ose në ndonjë adresë tjetër të cilën Palet mund t'ja njoftojnë njëra tjetrës here pas here.

Adresat janë:

Adresa e Klientit: e-mail: _____

Kaba Travel Tours

Klienti

Administratori

[emër, mbiemër, firmë]

[emër, mbiemër, firmë]

Z. Kevin Kaba

[emër, mbiemër]

Ne kuptim të nenit 12 të kësaj Kontrate dhe nenit 6.1.a) të Ligjit 9887, Klienti me vullnet të lire jep pëlqimin me shkrim për përpunimin e të dhenave personale të tij/saj nga Kaba Travel Tours në kuadër dhe për zbatimin e kësaj Kontrate.

Po ashtu, në kuptim të nenit 686 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë deklaroj në mënyrë të shprehur se kam lexuar, kuptuar dhe pranuar klauzolat dhe dispozitat e mëposhtme:

Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 e 13 të kësaj Marrëveshje.

Klienti

[emër, mbiemër, firmë]

Tiranë, më _____. _____. 2018